

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 96, Datë 30.06.2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 28.04.2022
DHE TË DATES 23.05.2022 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË


Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 28.04.2022 dhe të datës 23.05.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 28.04.2022 dhe të datës 23.05.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 28.04.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 26

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 26 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 1

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me rendin e ditës kam nga ekzekutivi një sugjerim ku pika 11 kalon në pika 10 dhe anasjelltas dhe pika 17 është diskutuar herën e kaluar si material dhe na ka mbetur vetëm për votim dhe shtimi i pikës 18 mbi ndryshimin e planit të punësimit. Ka diçka tjetër për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KALUAR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar për këtë pikë? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUËSHËTZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE,DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR,PËR PERIUdhËN 1 – 31 MARS 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: Për muajin mars, janë 45 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar, fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga lista e përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Administratorët e sektorit të pagesave, i propozojnë Këshillit të Bashkisë që gjatë muajit Mars: për muajin Mars 2022, është në dispozicioni fond prej 226.120 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit;nga ky fond, përfitojnë 45 familje, të përzgjedhura sipas kritereve specifike të miratuara, në shumën 113.542 lekë;po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 25 familje, në shumën 31.552 lekë;pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 145.094 lekë;të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor,sipas kritereve specifike të miratuara 29 familje, me fond prej 92.114 lekë. Ftoj Këshillin ta miratojë këtë pikë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

MBI MBËSHTETJEN FINANCIARE TË FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA BUXHETI VENDOR, PËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË NDIKUARA NGA LUFTA NË UKRAINË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mund të na i shpjegojë direkt ekzekutivi pa hyrë tek Komisioni?

Ekzekutivi A.Vranishti:Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” , të ndryshuar dhe të nenit 11,të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022” tëndryshuar, me propozim të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave bazuar në Vendimin Nr.159, datë 12.03.2022,vendosi të përfitojnë mbështetje financiare, në masën 3.000 lekë, në muaj për një periudhë tre mujore,Prill, Maj, Qershor 2022;kategoritëpërfituese të ndihmës ekonomike të përcaktuar në nenin 7 të ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, individët e pagesës së kufizuar, individët e statusit invalid paraplegjik dhe tetraplegjik dhe për statusin e të verbrit.Për të gjitha këto arsye, Bashkia Korçë, duke mos përjashtuar nga ky vendim, familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike nga buxheti vendor, ka vënë në dispozicion një fond nga buxheti vendor i Bashkisë për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta edhe për këtë kategori,duke u mbështetur

në ligjin nr 139/2015 “Përvetëqeverisjenvendore”, e një sërë legjislacion mbështetës. Ju ftojme në miratim të kësaj pike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË APLIKIMIT “KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL”.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: Për paraqitjen e kërkesave për strehim social, individët/familjet duhet të aplikojnë sipas formatit bashkëlidhur V.K.M. nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfitur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Aplikimet paraqiten drejtpërdrejt në strukturën përgjegjëse për strehimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose pranë njësive administrative më të afërta me qendrën e banimit të personave që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social. Bazuar në pikën 2 , neni 14 të ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social“, pika 5 në V.K.M. nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfitur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, paraqitet për miratim formatin e aplikimit sipas modelit bashkëlidhur materialit që na është shpërndarë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës.

PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI MATERIAL NË VKB NR.34, DATË 24.02.2022 PË SA I PËRKET TITULLIT "MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE TË PROGRAMIT "BANESA SOCIALE ME QIRA".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përsëri Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj. Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I. Nikaj: Këshilli i Bashkisë Korçë me vendim Nr. 34 datë 24.02.2022 mirato propozimin e Drejtorisë së Strehimit Social përsistimin e pikëzimit dhe përzgjedhjen e përfituesve në programin “Banesat me Kostotë Ulët”. Përshkaktën një gabim material në titullin e vendimit nr. 34 datë 24.02.2022, bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar dheligjin 22/2018 “Për strehimin social” propozojmë: korrigjimin e gabimit material në titullin e vendimit Nr. 34 dt. 24.02.2022 të Këshillit të Bashkisë Korçë duke u riformuluar si më poshtë: Mbimiratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit “Banesat me Kostotë Ulët”. Ju ftoj më për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës.

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË NDIHMËS FINANCIARE PËR ZNJ. MARIELA STEFANLLARI, SË CILËS I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi; Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit znj. Edlira Mitre mund të vazhdoni.

Këshilltare E. Mitre: Në datën 30.03.2022, në banesën e znj. Mariela Stefanllari me adresën e përcaktuar në material ra zjarr ku pati dëme nga ana ndërtimore si dhe orendi shtëpiake. Mbështetur në preventivat e bëra nga Komisioni i Ekspertëve në Këshillin e Qarkut për dëmet e shkaktuara i propozohet Këshillit të Bashkisë për dhënien e ndihmës financiare për përballimin e disa shpenzimeve emergjente në shifrën e 171.225 lekësh.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.146, DATË 22.12.2021 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMERUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, kush do e marrë fjalën?

Këshilltare M.Nene: Bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe në VKM nr. 717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore" i ndryshuar, është miratuar niveli i pagave me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 146 datë 22.12.2021 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në institucionin e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2022". Sipas VKM nr. 158 datë 12.03.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" është përcaktuar se paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi është 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë. Për këtë arsye kërkojmë që për Bashkinë Korçë dhe Ndërmarrjet në varësi për klasën I të ndryshohet kategoria fikse nga 30 000 lekë në 32 000 lekë dhe për klasën II të ndryshohet kategoria fikse nga 31 600 lekë në 32 000 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje kam unë, se kemi lënë një diskutim nga rradhët e kaluara në lidhje me disa persona që e kanë pagën më pak se minimum.

Ekzekutivi A.Dishnica: E kam shpjeguar unë njëherë këtë çështje që nuk ka punonjës me pagë nën minimalen dhe për ata që u diskutua ia u shpjegova që lidhej me orët e punës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ka diçka tjetër për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR SHPENZIMET E KRYERA TË PROJEKTIT LED ME FINANCIM TE HUAJ (IPA).

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare znj.Mamica mund të vazhdoni.

Këshilltare M.Nene: Këtë material e diskutuam dje me znj.Aida ku na shpjegoi gjithë procedurën që do të ndiqet me fondet. Nga relacioni mund të themi se në kuadrin e Programit Interreg IPA i Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi- Shqipëri 2014-2020, Bashkia e Korçës ka fituar dhe ka zbatuar projektin ndërkufitar "LED" Drejt rrugës për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në shkollat publike dhe për të propaganduar përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme. Objektivi kryesor i projektit është të ofrojë një zgjidhje të integruar, në nivel

ndërkufitar, ndaj sfidës së mos progresit në fushën e efijencës energjetike të ndërtesave publike dhe përdorimit të tyre, në përputhje me politikat përkatëse të BE-së dhe legjislacionin kombëtar. Projekti u fokusua në një bashkëpunim ndërkufitar drejt efijencës së energjisë, përmes investimeve në shkallë të vogël në efijencën e energjisë dhe përdorimin e tyre në ndërtesat e shkollave publike, zbatimin e aksioneve pilot për kursimin e energjisë në ndërtesat publike, duke përfshirë përdorimin e mjeteve inteligjente të teknologjisë dhe nismat e përbashkëta ndërgjegjësuese për publikun. Gjatë zbatimit të këtij projekti janë realizuar një pjesë e zërave buxhetore, duke përdorur fondet e vëna në dispozicion nga donatori, në këtë rast Bashkimi Europian, deri në afatin e përfundimit të projektit, duke përdorur sistemin e vlerësimit të performancës së projektit. Gjithë të dhënat e tjera me detaje i gjeni në material, ju ftojme për miratim.

Këshilltare I.Nikaj: Një pyetje kisha unë, cilat shkolla janë pjesë e këtij projekti?

Ekzekutivi A.Shkodrani: Është parashikuar të përfshihet vetëm një shkollë, shkolla 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi".

Këshilltare I.Nikaj: Atëherë unësugjeroj që të shihet me kujdes situata si këto për të gjitha shkollat, sepse ne në përgjithësi kemi shumë probleme me pjesën e ngrohjes, duhet menduar seriozisht për këtë punë dhe për alternativa të tjera që do të na ndihmojnë në sigurimin e ngrohjes.

Ekzekutivi K.Kita: Besoj se kushtet e shkollave të qytetit dihen dhe jo të gjitha mund të përshtaten për të zbatuar projekte të tilla. Megjithatë, ne kemi miratuar në Këshill edhe një zgjatje të kohës me një muaj të ngrohjes në shkollat e qytetit në bashkëpunim me Ndërmarrjen Mbështetëse të Shkollave dhe Çerdheve dhe ndërkohë jemi duhe studiuar edhe infrastrukturën e ngrohjes së shkollave për të bërë gjithë riparimet e nevojshme dhe për të llogaritur gjithë kostot e termoizolimit të shkollave.

Këshilltare I.Nikaj: Unë i vlerësoj shumë këto që thoni ju po them se duhet të mendohet seriozisht një përdorim më efikas të energjisë së rinovueshme. Ndoshta duhet një projekt 4-5 vjeçar për ta studiuar këtë situatë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nëse nuk ka diçka për të shtuar kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës

PËR DISA SHITESA NË V.K.B. Nr. 28, Datë 28.02.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE PËR VITET 2020 - 2022" TË NDRYSHUAR

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, znj.Mamica mund të vazhdoni.

Këshilltare M.Nene: Na është paraqitur relacioni Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB nr. 151 datë 27.12.2018 “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe të buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, si dhe një sërë udhëzimesh të tjera. Parashikohen ndërhyrje të rëndësishme si: ndërtim muri mbajtës në Kamenicë, ndërtim kanali në Barç e të tjera ndërtime që janë të detajuara në material edhe në vlera monetare. Ju ftoj për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Këto dy pika kam përshtypjen që lidhen apo jo? Do të bashkëfinancohen?

Këshilltare M.Nene; Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, nëse nuk ka diçka për të shtuar e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës

PËR PLANIFIKIMIN E BASHKËFINANCIMIT NË KUADËR TË HAPJES SË THIRRJES PËR PROGRAMIN “FONDI PËR MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE NATYRORE”.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përsëri Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, znj.Mamica mund të vazhdoni.

Këshilltare M.Nene: Në kuadrin të hapjes së thirrjes për Programin “Fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore” nga Ministria e Mbrojtjes, bazuar në Ligjin 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, neni 15, Bashkia Korçë do të aplikojë me projektin “Ndërhyrja për shmangien e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”. Objektivi kryesor i projektit është të ofrojë zgjidhje, në nivel bashkiak, ndaj sfidës së përballjes me fatkeqësitë natyrore si përmytjet dhe erozioni. Projekti do të përfshijë një sërë investimesh të cilat do të përmirësojnë kushtet infrastrukturore të zonave të caktuara dhe të planifikuara edhe ne prioritetet e Bashkisë Korçë 2022. Kostoja totale e projektit shkon në vlerën totale 61.320.258 lekë. Bashkia Korçë sipas kushteve të programit duhet të planifikojë në strukturën buxhetore të saj fondin e bashkëfinancimit prej 10% të shumës totale të projektit, pra 6,132,026 lekë. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2022 në programin Rrjeti Rrugor Rural, “Investime në Infrastrukturën Rrugore”.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra, kemi një fond, nga do të vijë ky fond?

Ekzekutivi V.Ziko: Në buxhetin e vitit 2022, nga Ministria e Mbrojtjes është hapur fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe Bashkia do të aplikojë me projektin ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçëku në planifikojmë bashkëfinancim në 10% të shumës totale të projektit, pra në 6,132,026 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra, 10% do jetë destinacioni apo kemi rritje në të ardhura?

Ekzekutivi V.Ziko: Jo nuk quhet rritje, ka qënë i programuar ky fond.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka dikush ndonjë pyetje? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës.

PËR MIRATIM PËR PËRDITËSIMIN E KUFIJVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë ndryshim në ky material? Nga Komisioni i Infrastrukturës nuk kemi asnjë anëtar kështu që mund ta marr ekzekutivi fjalën.

Ekzekutivi A.Çela: Mbështetur në: Ligji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji nr. 9270 datë 20.07.2004 Për Sistemin e Adresave (Ndryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016) (i përditësuar) , neni 4/1 që thekson se : “Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave” dhe shkresa nr.44 prot. e datës 03/02/2022 e Ministrisë së Brendshme ku kërkohet të azhurnohen kufijtë e ndarjeve administrative, përkatësisht për rendin e 4-t (Kufijtë e Njësive Administrative) dhe të 5-të (Kufijtë e Fshatra/Qytete) në formatin shapefile - GIS, në përputhje me standardet e miratuara për këtë temë të informacionit gjeohapësinor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 13 e rendit të ditës

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË OBJEKTIT ME SIPËRFAQE TOTALE PREJ 390 M2, PJESË E PASURISË ME NR.4/167 VOL.42, FQ.57. ZK 8564, NË ISH UMB KORÇË, SIPAS GENPLANIT BASHKËLIDHUR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj.Kristo: Bashkia Korçë ka në pronësi pasurinë me nr.4/167, vol.42 fq.57 me sipërfaqe 692.50 m2 truall dhe ndërtesë Objekti ndodhet në zonën e Ish Uzinës Mekanike Bujqësore.Një pjesë e kësaj pasurie, konkretisht 390 m2 sipërfaqe ndërtesë, i është dhënë me qira subjektit Skendian Larti me Nipt: K33810019L, me kontratë datë 29.05.2019, për një afat 3 vjeçar, deri më 28.05.2022, për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike sipas objektit të shoqërisë.Me kërkesë datë 07.04.2022 protokolluar pranë Bashkisë Korçë më datë 07/04/2022 me nr. 2599 Prot. është kërkuar nga ana e subjektit Skendian Larti rinovimi i kontratës së qirasë.Me qëllim vazhdimin e shfrytëzimit të këtij objekti në pronësi publike të Bashkisë Korçë, dhe me misionin e një menaxhimi sa më eficient të aseteve të saj, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë fillimin e procedurave për dhënien me qira të kësaj sipërfaqeje ndërtimi, me tarifën dysheme në fuqi të qirasë mujore për ndërtesat në qarkun e Korçë prej 150 lek/m2, për një afat kohor 1 (një) vjeçar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij relacioni.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 14 e rendit të ditës

PËR BLERJEN E SIPËRFAQEVE TOKË TRUALL TË CILAT MBIVENDOSEN ME PASURITË NË PRONËSI TË DHIMITRAQ PROTO DHE ILIA PROTO, MBI CILAT NDODHET SHKOLLA DEMIR PROGRI DHE BAZA PRODHUESE E SHKOLLËS DEMIR PROGRI.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në rradhë të pare materiali duhet rregulluar pak se ka disa gabime dhe më pas mund të vazhdojë Komisioni i Rregullores.

Këshilltari Gj.Kristo: Bëhet fjalë për tre pasuri konkretisht pasuria Nr. 1/341 ku mbivendoset në sipërfaqen 92.7m2 truall nga e cila 8m2 janë ndërtesë;pasuria 1/664 ku mbivendoset në sipërfaqen 28.6 m2 truall; pasuria 1/642 ku mbivendoset në sipërfaqen 753.4 m2 truall nga e cila 256.7 m2 janë ndërtesë. Pronarët e truallit kanë shprehur pëlqimin për realizimin e shitjes, t'i shesin sipërfaqet e zëna nga ndërtimet, Bashkisë Korçë sipas vlerës së përcaktuar nga aktet nënligjore në fuqi. Në marrëveshje me pronarët, është rënë dakord të blihet nga ana e Bashkisë Korçë sipërfaqja e zënë sa më lart relativisht, me vlerën e caktuar nga VKM nr.89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë". Blerja e këtyre sipërfaqeve do të bëhet me këste sipas parashikimeve në buxhetin e vitit përkatës.Si rrjedhojë, duke qënë se pasuria pronë private është zënë nga ndërtimi i shkollës Demir Progri dhe baza prodhuese, që shërbejnë për realizimin e funksioneve të Bashkisë, në fushën e arsimit dhe

realizimin e programeve arsimore, në referim të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe meqënëse e drejta e pronësisë ushtrohet nga Këshilli Bashkiak sipas nenit 54 të ligjit 139/2015, kërkohet nga Këshilli Bashkiak Korçë të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë, të nënshkruajë kontratën e shitblerjes për pasuritë që mbivendosen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Anxhela mund të thuash diçka më tepër?

Ekzekutivi A.Dishnica: Referuar Ligjit 8744 dt 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësisive të qeverisjes vendore”, në nenin 3 të tij përcaktohet se “U transferohen në pronësi njësisive të qeverisjes vendore, pronat që përdoren për realizimin e programeve arsimore”. Në VKM 1532 dt 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë” e ndryshuar, me numër rendor 543 e në vijim, (Shkolla e Mesme Demir Progri dhe Baza Prodhuese), prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, transferohen në pronësi të Bashkisë Korçë. Ndodhur në kushtet kur ndërtesat, Shkolla Demir Progri dhe Baza Prodhuese janë të ndërtuara, të mbivendosura mbi pasuritë truall pronë private të z Dhimitraq Proto dhe Ilia Proto, dhe në kushtet e zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë lind nevoja për blerjen e sipërfaqeve tokë truall mbi të cilat janë ndërtuar godinat e shkollës dhe bazës prodhuese, prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. Dhe diçka tjetër, nëse miratohet kjo pike, herës tjetër në mbledhje do të përgatisim një material tjetër që kanë lidhje me njëra tjetrën ku do të shpjegohet fondi nga i cili do të realizohen këto shpenzime.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka nga këshilltarët për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 15 e rendit të ditës

PËR BLERJEN E SIPERFAQES PREJ 131 M2 TOKE ARË ME NR.PASURIE 59/3 ZK.3030 NË PORODINË, NJËSIA ADMINISTRATIVE BULGAREC ,NE PRONËSI TË Z.HASAN HAJRIDIN MYRTOLLARI, AKTUALISHT SIPËRFAQE E ZENE NGA STACIONI I POMPIMIT TË UJIT.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj.Kristo:Pranë Bashkisë Korçë më datë 26.01.2021 ka ardhur një shkresë nga Njësia Administrative Bulgarec e cila bënte me dije se Z.Hasan Myrtollari, banues në fshatin Porodinë, pronar i pasurisë nr.59/2 zk 3030, pretendon se mbi tokën e tij është ndërtuar një pus nga ish komuna Bulgarec, i cili furnizon me ujë fshatin Porodinë, dhe si rrjedhojë kërkohet të ndiqet procedura për dëmshpërblim. Pas verifikimeve të kryera në vend dhe në vazhdimësi të

komunikimeve me palën kërkuese, u ra dakord që Z.Hasan Myrtollari t'ia shesë sipërfaqen e zënë nga pusi Bashkisë Korçë sipas vlerës së përcaktuar nga aktet nënligjore në fuqi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 16 e rendit të ditës

PËR DHËNIEN ME QIRA TË AMBIENTEVE TË KATIT TË DYTË DHE TË TRETË TË ISH KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË ME QËLLIM ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë z.Gjergji Kristo mund të merrni fjalën.

Këshilltari Gj.Kristo: Bashkia Korçë ka në pronësi godinën e ish Këshillit të Qarkut me vendndodhje në Bulevardi Republika, pranë Katedrales së qytetit. Kjo pasuri ka kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 601, datë 31.8.2016 "Për kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë të Bashkia Korçë, dhe kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Bashkia Korçë të këshilli i Qarkut Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1223, datë 3.9.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi Këshillit të Qarkut Korçë".Nëpërmjet VKM-së së sipërcituar ndërtesa dhe mjediset administrative të Ish Keshillit te Qarkut dhe Prefektures Korçë i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Korçë. Pas rikonstruksionit të kësaj godine u krijuan kushte të përshtatshme për një shfrytëzim optimal të këtyre ambienteve.Shfrytëzimi i këtyre ambienteve do të ketë qëllim zhvillimin e aktiviteteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, konkretisht formimin profesional të të rinjve në fushën e shkencave kompjuterike.

Ekzekutivi K.Kita: Me këtë material u hapim rrugë operatorëve që janë të interesuar drejt rrugës së teknologjisë për zhvillimin e tyre. Fokusi është vetëm tek teknologjia e informacionit. Bëhet fjalë për një afat të lidhjes së kontratës për sipërfaqet 200 - 500 m2 deri në 10 vjet, ndërsa për sipërfaqet mbi 500 m2 deri në 20 vjet.

Ekzekutivi A.Dishnica: Dy janë pikat kryesore të materialit, qëllimi për të cilin do të përdoret dhe sipërfaqja që do të llogaritet për përdorim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me çmimin çfarë mund të themi?

Ekzekutivi A.Dishnica: Tarifa dysHEME për fillimin e procedurës së qirasë do të jetë sipas gërmës a) të Kreut III të VKM-së 54/2014, e barabarte me 0.3% të vlerës mesatare të shitblerjes së banesave e përcaktuarnë udhëzimin përkatës të Këshillit të Ministrave, Udhezimi nr.3 datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", që rezulton të jetë 137.5 lekë/m²/muaj. Vlera e qirasë nëpërmjet së cilës do të jepen në përdorim këto ambiente, propozohet të mos jetë më e vogël se 150 lekë/m²/muaj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mua personalisht nuk më pëlqejnë shumë dhënie në përdorim për periudha kaq të gjata kohore, sepse realisht 10 vite janë shumë kujtdo që i jepet e drejta e përdorimit, megjithatë ju mund ta keni më të qartë situatën. Ne sapo kemi investuar aty, mirë do ishte të kishim edhe informacion mbi pjesë të tjera që i kemi dhënë në përdorim, si janë rezultatet me to. Keni diçka për të shtuar?

Këshilltari I.Nikaj: Unë mendoj se duhet të tregohemi të kujdesshëm në dhënie e të tilla pronave në përdorim dhe të kishim një parashikim të efektivitetit që do të sillte kjo gjë, ku është leverdia jonë në fushat që do të preken. Shoh me rëndësi edhe rishikimin e afateve të këtyre kontratave se jemi pak shumë dorëlëshuar për këto pasuri publike.

Këshilltari P.Bello: Unë mendoj të sqarohemi pak kur mbarojnë ato punimet aty se u bë kohë e gjatë që po vazhdojnë, çfarë po ndodh aty. Komentoni pak se Korça nuk ka një pallat kulture, nuk ka një shtëpi për bandën e qytetit, për korin Lira, mendoni pak edhe për këto gjëra, nuk kanë ambiente këto grupe, vlerë e qytetit tonë, nuk iu shqetëson kjo gjë? Shfrytëzoheni ambientin me kujdes, mos i zini të gjitha hapësirat.

Këshilltari M.Doççe: Shqetësimet e profesorit janë të drejta, por unë do doja të flisja pak për pjesën e Hub-it që unë përfaqësoj, meqenëse edhe në material u përmend si qëllim pjesa e teknologji-informacionit. Dallimi i këtij materiali nga Hub-i është se këtu bëhet fjalë për dhënie me qera, ndërkohë që Hub-i është në bashkëfinancim dhe çdo fitim që gjenerohet shkojnë në përqindje të caktuar në Bashkinë Korçë. Nëse flasim për teknologjinë, benefitet dhe të mirat e saj janë pafund, për zhvillimin dhe punësimin e të rinjve, interesi është i madh, flas nga eksperiencia, kështu që qëllimi i materialit mbi teknologjinë është i drejtë për t'u mbështetur.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Flasim për pjesën e trajnimit, tek Hub-i juaj realizohet trajnimi, këtu flitet për tjetër gjë, për më tepër mua më shqetëson afati i gjatë. Ndërsa për pjesën që thotë profesori, është shumë i drejtë si shqetësim dhe ka vërtet diçka që nuk shkon me këtë situatë. Edhe materialit, po ti futesh me thellësi ka gjëra që nuk shkojnë, se ish-qarku nuk ekziston fare, mënyra e të shprehurit nuk është e drejtë.

Këshilltari I.Nikaj: Ju përderisa vini me një hap të tillë, duhet të keni parë se çfarë është arritur me shembuj të tjerë dhe të na i servimi.

Ekzekutivi K.Kita: I kemi rezultatet ne dhe po ja u tregojmë, vizionin dhe qëllimin.

Këshilltari I.Nikaj: Dakort jam, po duhen menduar pak më mire gjërat, duhen njerëz të kualifikuar dhe infrastrukturë e mirëmenduar për gjithë këtë zhvillimin e teknologjisë që ju

pretendoni. Këto sillen në materiale të organizuara me detaje, ku të shpjegohen rezultatet që priten dhe çdo gjë tjetër shumë më ndryshe, më të kuptueshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ne kemi plot banesa sociale, pallate ku katet e para janë bosh, mund ti shfrytëzojmë dhe mos përdorim një pronë me qera në mes të qytetit për këto qëllimet e teknologjisë.

Ekzekutivi K.Kita: Tani sot kemi mungesë të kryetarit, i cili mund ta shpjegonte shumë më mirë materialin, por diçka këtu u tha, mbi rëndësinë dhe shembullin e Hub-it, ndodh e njëjta gjë edhe me materialin në fjalë dhe nuk është e vërtetë që po fshehim ndonjë gjë me emërtimin apo vendndodhjen e ish-qarkut. Për punimet që përmendi z.Bello, punimet kanë mbaruar, kanë mbetur vetëm disa gjëra të vogla, ndërsa për ambientet e korit Lira dhe banda e qytetit nuk di të them, patjetër duhet parë si çështje duke studiuar kushtet që kemi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë përsëri mendoj se marrja e një vendimi të tillë për të ndryshuar një pronë publike me qera në qëllimin që ju thoni kërkon një analizë të plotë dhe të mirëfilltë. Tani jemi përballë një shqetësimi konkret, fakt që profesor Pandi na i shfaqti dhe mos kemi një mjedis ne për t'iu ofruar nderit të kombit, grupit Lira, më falni po kjo nuk mund të kalohet lehtë. E vërtetë është edhe pjesa që nëse do të ishte kryetari do të kishim përgjigje më shteruese dhe mendoj se nuk është nevoja ta votojmë sot, po nëse do ekzekutivi ta votojmë sot e votojmë.

Ekzekutivi K.Kita: E lemë për herën tjetër meqënëse kryetari nuk është sot për t'i dhënë një shpjegim ashtu siç duhet, ashtu siç ai e ka vizionuar këtë projekt.

Pika 17 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË 30% TË TRUALLIT TË DHËNË PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT "SHTESË OBJEKTI REPART PRODHIM MERMERI NË DRENICË" NGA KRT KORÇË, ME VENDIM NR.380 DATË 12.09.1998 NË FAVOR TË Z.ARDI FEZGA, PËR EFEKT REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ky është një material që është diskutuar, por në mungesë të kuorimit nuk u hodh në votim. Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 18 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 23 DATË 10.02.2022 “PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022”.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ekzekutivi ka diçka për të shtuar?

Ekzekutivi A.Dishnica: Bazuar në VKB nr. 23 datë 10.02.2022 “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2022”, në nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” dhe në urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 46 datë 01.02.2022 “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2022” i ndryshuar, është miratuar plani vjetor për rekrutimin në shërbimin civil për vitin 2022. Në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil është parashikuar numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurimi për çdo kategori dhe klasë si dhe grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm. Për shkak të disa ndryshimeve në strukturën e Bashkisë Korçë, kanë ndryshuar dhe vendet vakante të nëpunësve civilë. Të gjitha ndryshimet janë të shpjeguara në relacioni thjesht është një procedurë standarte.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 19 e rendit të ditës

INFORMACION NË LIDHJE ME INVENTARIZIMIN E AKTIVEVE AFATGJATA DHE AFATSHKURTRA DHE MATERIALE TË BASHKISË KORÇË DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2021

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ky është një informacion thjesht për të na vënë në dijeni, nuk ka nevojë për diskutime.

Pika 20 e rendit të ditës

KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kemi një kërkesë që është paraqitur nga një subject, në pjesën e turizmit dhe akomodimit, shoqëria “Life Gallery Shpk”. Në përmbledhje kërkesa ka të bëjë me një urë lidhëse midis projekteve që kalon në një rrugë publike dhe shkallët e emergjencës që janë të kërkuara nga shërbimi zjarrfikës. Ekzekutivi ka sjellë një interpretim të kësaj kërkesë, sepse objekti ndodhet në pjesën historike të qytetit tone në mos gaboj. Megjithatë le të dëgjojmë njëherë kërkesën nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe pastaj flasim për përgjigjen.

Përfaqësues i Shoqërisë "Life Gallery Shpk": Kërkesa jonë konkretisht bazohet në marrjen e pëlqimit tuaj për krijimin e servitutit të kalimit në një hapësirë publike me sipërfaqe 12m2 të ndodhur mbi pasurinë me nr.6/267, ZK.8561,vol.29,f.142 për të mundësuar vendosjen e një shkalle emergjence dhe urë kalimi në njësinë akomoduese turistike ndodhur në rrugën Perlat Rexhepi, lagjia 11. Konkretisht duke u mbështetur në bazën ligjore kërkohet krijimi i hapësirave të cilat të mundësojnë vendosjen e shkallëve të emergjencës metalike për të dy objektet për të dale direkt në rrugë publike. Të gjitha shpjegimet janë dhënë me detaje dhe me dokumentat e pronësisë në kërkesën që ne kemi depozituar pranë Bashkisë Korçë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani unë mesa kuptoj dhe kam studiuar kërkesën tuaj, me këtë bazë ligjore nuk mendoj se është e saktë për kërkesën tuaj, megjithatë le të flasë Anxhela më saktë, të na shpjegojë dhe përgjigjen që institucioni ka dhënë ndaj kërkesë suaj.

Ekzekutivi A.Dishnica: Në datën 08.04.2022 pranë Bashkisë Korçë është paraqitur një kërkesë nga shoqëria Life Gallery shpk e cila ka për objekt dhënien e pëlqimit për krijimin e servitutit të kalimit në një hapësirë publike për një sipërfaqe 12 m2 për të mundësuar vendosjen e një shkalle emergjence dhe urë kalimi në njësinë akomoduese turistike të ndodhur në rrugën "Perlat Rexhepi", lagjia nr 11 Korçë.Referuar nenit 261 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë servituti është barra që i ngarkohet një prone, për përdorimin dhe dobinë e një prone të një pronari tjetër. Pra nga përkufizimi i servitutit kuptojmë që ai vendoset mbi një pronë. Në kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Life Gallery" shpk citohet prona me nr 6/267 ZK 8561 V.26 f142 e cila është rrugë publike dhe konkretisht rruga "Perlat Rexhepi".Nëse më pas i referohemi nenit 277 të Kodit Civil referohet qartazi se " Pronari që nuk ka dalje në rrugën publike dhe nuk mund ta sigurojë atë përveç se me shpenzime të mëdha e me vështirësi, ka të drejtë të ketë rrugë kalimi nga toka fqinje, për përdorimin e përshtatshëm të pronës së vet. Kalimi duhet të përbëjë rrugën më të shkurtër për në rrugën publike dhe me më pak dëme për pronën shërbyese..."Nga dispozitat e mësipërme rezulton se kërkesa për vendosjen e një servituti duhet të plotësojë dy kushte: së pari: duhet të vendoset mbi një pronë dhe së dyti pronari nuk duhet të ketë dalje në rrugë publike.Ndërkohë nga përmbajtja e kërkesës së subjektit Life Gallery, rezulton që servituti kërkohet të vendoset mbi pasurinë 6/267 ZK 8561 V.26 f 142 e cila është rrugë publike dhe referuar planvendosjes të dy pasurive 6/531 dhe 6/462 në pronësi të subjektit Life Gallery rezulton se të dyja pasuritë kanë dalje në rrugën publike.Pasuria 6/462 ka dalje në të dy anët e saj në rrugë publike. Meqënëse shoqëria pronare ka në pronësi katin e parë dhe të dytë të godinës servitutit e kalimit mund tja kërkojë pronarëve të katit përdhe të të njëjtës godinë me qëllim daljen në rrugë publike.Gjithashtu referuar sërish dispozitave të K.Civil në asnjë rast nuk parashikohet servituti i kalimit në ajër dhe mbi rrugën publike.Neni 281 I K.Civil disponon se: "Pronari mund të krijojë mbi pronat e veta ose në dobi të tyre, çdo lloj servituti, me kusht që të mos jetë në kundërshtim me rendin juridik", ndërkohë ndërtimi i një urë lidhëse mbi rrugën publike bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fushën e ndërtimit në atë zonë dhe konkretisht me VKM 207, datë 15.03.2017 "Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruardhe administrimin e saj dhe të zonës së mbrojtur përreth" Neni 8. Në përfundim unë them se fakti që kjo kërkesë që na shtrohet bën pjesë në një zone të mbrojtur, ku kërkohet paraprakisht edhe miratimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Trashëgimisë Kulturore, s'mund të veprojë edhe pa përgjigjen e saj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë mendoj se pasi të zbardhet edhe procesverbali t'i kthehet edhe një përgjigje shoqërisë Life Gallery për ta sqaruar edhe më mirë për pretendimet e tyre.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI

ERJON NEXHIPI

